		<b>ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS</b> <b>KOSOVO DOCTORS CHAMBER</b> <b>LEKARSKA KOMORA KOSOVA</b>	
Njësia:		Nr. Prot.:	12/2024
Unit:	KO	Prot. No.:	
Jedinita:		Br. Prot.:	
Nr. i faqeve:	-28-	Data:	04.11.2024
No. of pages:		Datum:	
Br. stranica:			
Prishtinë			



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

## Rregullore

Për

Anëtarësim, Licencim dhe Rilicencim të Mjekut në O M K

Prishtinë, Nëntor 2024

**KUVENDI I ODËS SË MJEKËVE TË KOSOVËS** në mbështetje të Nenit 19, paragrafit 1, nënparagrafit 1.1 të Ligjit nr. 04/L-150, për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Nenit 22 paragrafi 1 me nënparagrafin 1.1 të Statutit të OMK-së, si dhe Nenit 23 të Rregullores për Procedurat Vendimmarrëse të Organeve të OMK-së, e miratuar në mbledhjen e datës 19 qershor 2018, e plotësuar dhe e ndryshuar në mbledhjen e rregullt të datës 04 nëntor 2024, miraton këtë:

**R r e g u l l o r e**  
**për**  
**Anëtarësim, Licencim dhe Rilicencim të Mjekëve në O M K**

(Teksti i spastruar me plotësime dhe ndryshime të miratuara sipas Vendimit nr. 09/2024 të Kuvendit të OMK-së, datë 4.11.2024)

**Kapitulli I - Dispozita të Përgjithshme**

**Neni 1**

**Qëllimi**

Rregullorja ka për qëllim të përcaktoj mënyrat dhe kriteret e Anëtarësimit, Licencimit dhe Rilicencimit të Doktorit të mjekësisë, Specialistit dhe Sub-specialistit të lëmisë përkatëse mjekësore, si dhe kushtet e menaxhimit të Regjistrimit përkatës në të cilët mbahet evidenca e të gjithë mjekëve anëtar dhe që posedojnë Licencën e punës, përfshirë edhe mjekët të cilët kanë qenë posedues të Licencës së punës.

**Neni 2**

**Fushëveprimi**

- Rregullorja zbatohet për procedurat e Anëtarësimit, Licencimit dhe Rilicencimit të Doktorit të mjekësisë, Specialistit dhe Sub-specialistit të lëmisë përkatëse mjekësore.
- Rregullorja përfshinë edhe dispozita për çështje tjera, që ndërlidhen me procesin e Licencimit dhe Rilicencimit të mjekut.
- Kjo Rregullore nuk zbatohet për Licencimin dhe Rilicencimin e mjekut me shtetësi të huaj. Licencimi dhe Rilicencimi i kësaj kategorie, rregullohet me akt të veçantë nënligjor të përgatitur nga Ministria e Shëndetësisë dhe të aprovuar nga Qeveria e Kosovës, në përputhje me Nenin 71, paragrafin 3 të Ligjit për Shëndetësinë.

### Neni 3 Përkufizimet

1. Nocionet dhe akronimet e përdorura në këtë Rregullore kanë këtë kuptim si në vijim:
  - 1.1 **EVP** – nënkupton Edukimin e Vazhdueshëm Profesional;
  - 1.2 **Faksimil** – nënkupton vulën unike të cilën i Licencuari e përdorë me rastin e lëshimit të dokumenteve dhe raporteve mjekësore në bashkëngjitje të nënshkrimit personal;
  - 1.3 **Komisioni për ALR - Komisioni për Anëtarësim, Licencim dhe RiLicencim;**
  - 1.4 **MSh** – nënkupton Ministrinë e Shëndetësisë;
  - 1.5 **Mjek** – nënkupton Doktorin e mjekësisë, Specialistin dhe Sub-specialistin i cili ka përfunduar programin universitar në arsimim të lartë, në ndonjërin nga institucionet e arsimit të lartë të akredituar nga organi kompetent shtetëror;
  - 1.6 **OMK** – nënkupton Odën e Mjekëve të Kosovës;
  - 1.7 **Specialist** – nënkupton mjekun e specializuar në ndonjërin nga lëmitë e fushës së mjekësisë;
  - 1.8 **Sub-specialist** – nënkupton mjekun i cili ka kryer program të caktuar të shkollimit sipas programeve të parapara për lëmi të ngushta specialistike, për fushën e caktuar mjekësore;
2. Nocionet dhe fjalitë që nuk janë të përfshira në përkufizimet sipas kuptimeve të dhëna në paragrafin 1 të këtij neni, do të interpretohen sipas kuptimeve të përgjithshme gjuhësore dhe njohurive të përgjithshme shkencore dhe teknike.

## Kapitulli II – Komisioni për ALR

### Neni 4 Kompetencat dhe përgjegjësitë

1. Komisioni për ALR është komision i përhershëm i Odës, i cili ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
  - 1.1 Mbikëqyr procesin e anëtarësimit të mjekut në OMK;
  - 1.2 Mirëmban dhe menaxhon bazën e të dhënave përkitazi me Regjistrin e mjekëve, Regjistrin e mjekëve të Licencuar dhe të Rilicencuar;
  - 1.3 Vendos në shkallë të parë për plotësimin e kushteve për Anëtarësim, Licencim dhe Rilicencim të mjekut;
  - 1.4 Udhëheqë me procesin e Licencimit dhe Ri-licencimit të mjekut;
  - 1.5 Së bashku me Kryetarin e OMK, lëshon Çertifikatën e Licencës së punës për mjekun;

- 1.6 Ekzekuton masat disiplinore lidhur me tërheqjen e përkohshme ose të përhershme të Licencës së punës dhe fshirjen nga Regjistri i anëtarëve të Odës, në bazë të Vendimit përfundimtar të Këshillit Etik apo Gjyqit të Nderit të Odës;
  - 1.7 Bashkëpunon me organet e tjera të Odës me qëllim të përmbushjes së funksioneve të përgjithshme të Odës; dhe
  - 1.8 Kryen detyrat të tjera sipas akteve normative të miratuara nga organi kompetent i Odës.
2. Komisionit për ALR mund t'i barten edhe përgjegjësi tjera nga organet e Odës përshtatshëmrisht me natyrën e funksioneve themelore të parapara me këtë Rregullore.

#### **Neni 5**

#### **Përbërja dhe zgjedhja e Komisionit për ALR**

1. Komisioni për ALR përbëhet prej 7 (shtatë) anëtarëve, të cilët zgjedhen nga Kuvendi i Odës, nga rradhët e anëtarëve të Odës.
2. Anëtari i Komisionit për ALR ka mandat 4 (katër) vjeçar, me të drejtë rizgjedhje edhe për një mandat tjetër.
3. Mënyra, kriteret dhe procedura e zgjedhjes së anëtarit të Komisionit për ALR, rregullohet me akt të veçantë normativ, për procedurat e zgjedhjes së organeve përfaqësuese të Odës.

### **Kapitulli III – Anëtarësimi i mjekëve**

#### **Neni 6**

#### **Regjistri i anëtarëve**

1. Mjeku që ushtron veprimtarinë profesionale ose veprimtari tjetër në sistemin shëndetësor në Republikën e Kosovës, është i obliguar që të anëtarësohet në Odën e Mjekëve të Kosovës (OMK).
2. Komisioni për ALR është organ kompetent i Odës i cili kryen anëtarësimin e mjekut dhe mirëmban Regjistrin e mjekëve që anëtarësohen në OMK.
3. Komisioni për ALR me rastin e anëtarësimit të mjekut në Odë, vlerëson plotësimin e kushteve të përcaktuara me këtë Rregullore, për fitimin e statusit të anëtarit të Odës.

4. Komisioni për ALR shqyrton kërkesën për anëtarësim të mjekut dhe pasi verifikon plotësimin e kushteve të parapara, të njëjtin e regjistron në Regjistrin e mjekëve të Odës. Regjistri i mjekëve përmban emrat e të gjithë mjekëve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e RKS.
5. Regjistri i mjekëve do të jetë publik në faqen zyrtare të Odës dhe do të përmbajë të dhënat e mjekut si në vijim:
  - 5.1 Emri, emri i prindit dhe mbiemri;
  - 5.2 Kodi i Licencës së punës;
  - 5.3 Afatshmëria e Licencës së punës;
  - 5.4 Thirrja profesionale; dhe
  - 5.5 Numri i anëtarësisë.

## **Neni 7**

### **Procedura e anëtarësimit**

1. Procedura e anëtarësimit iniciohet me dorëzimin e kërkesës për anëtarësim në Odë (Shtojca I), të cilin e plotëson mjeku ose personi i autorizuar nga ai/ajo, i cili ka për detyrim ligjor anëtarësimin në Odë.
2. Personi i autorizuar, me rastin e aplikimit për anëtarësim, bashkë me dokumentacionin përcjellës, duhet të dorëzoj edhe Autorizimin e noterizuar.
3. Kërkesa për anëtarësim përmban të dhënat si në vijim:
  - 3.1 Emri, emri i prindit dhe mbiemri;
  - 3.2 Data e lindjes;
  - 3.3 Numri personal;
  - 3.4 Shtetësia;
  - 3.5 Të dhënat për institucionin shëndetësor ose institucionin tjetër në të cilin ka punuar, vendin aktual të punës, pozitën, respektivisht institucionin shëndetësor në të cilin është në marrëdhënie të punës;
  - 3.6 Te mjeku që është i punësuar në sektorin publik, shënohet numri i pagës (EM kod);
  - 3.7 Statusi profesional, Doktor i mjekësisë, Specialist ose Sub-specialist i lëmisë përkatëse;
  - 3.8 Adresa aktuale;
  - 3.9 Të dhënat mbi komunikim, që përfshijnë numrin e telefonit personal dhe/ose të zyrës dhe adresa e postës elektronike (e-mail);
4. Dokumentet në vijim që duhet t'i bashkangjiten kërkesës për anëtarësim janë:
  - 4.1 Dy (2) fotografi me dimensione 3x4cm;
  - 4.2 Letërnjoftimi që dëshmon validitetin në formatin kopje;
  - 4.3 Licenca e punës-kopje e noterizuar, në rast se është posedues i saj;
  - 4.4 Diploma e studimeve-kopje e noterizuar; si dhe

4.5 Dëshmi tjera si Certifikatë apo Diplomë të noterizuar, të cilat vërtetojnë specializimin/aftësimin profesional dhe kualifikimin Sub-specialistik;

5. Kërkesa për anëtarësim duhet të nënshkruhet dhe të dorëzohet nga mjeku ose i autorizuari i tij, në zyret e Odës. Shërbimi profesional i Odës do të procedojë kërkesën e tillë për shqyrtim pranë Komisionit për ALR.
6. Të dhënat personale nga paragrafi 2 dhe 3 i këtij neni do përpunohen në pajtim me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
7. Mjeku anëtar i Odës është i obliguar që çdo ndryshim të të dhënave personale, statusit profesional dhe statusit të punësimit në institucion, t'a raportoj te Shërbimi Profesional i Odës dhe Komisioni për ALR, më së largu 30 (tridhjetë) ditë nga ndryshimi respektiv.
8. Mjeku i papunësuar që aplikon për anëtarësim në Odë, duhet të dorëzojë Listën shpjeguese të pagave për të punësuar e lëshuar nga ATK, për periudhën 1 (një) vjeçare.
9. Nëse brenda periudhës 1 (një) vjeçare të deklaramit tatimor, figurojnë të hyra për 6 muaj apo më shumë, atëherë mjeku nuk konsiderohet si i papunësuar për atë periudhë kohore.

#### **Neni 8**

#### **Anëtarësimi i mjekut shtetas i RKS që ushtron veprimtarinë e tij jashtë Republikës së Kosovës**

1. Mjeku me shtetësi të Republikës së Kosovës i cili ushtron veprimtarinë mjekësore jashtë territorit të Republikës së Kosovës, por shpreh vullnetin të anëtarësohet në Odë, mund të paraqet kërkesën për anëtarësim, në pajtim me kushtet siç janë paraparë me dispozitat e këtij neni, përkitazi me anëtarësimin e mjekut shtetas i RKS që ushtron veprimtarinë e tij në RKS.
2. Procedura e anëtarësimit do të bëhet në përputhje me dispozitat e nenit 6, 7 dhe 10 të kësaj Rregulloreje.

#### **Neni 9**

#### **Anëtarësimi i mjekut shtetas i huaj (jo-kosovar)**

1. Mjeku që ka shtetësi të huaj dhe që dëshiron të ushtrojë veprimtarinë e tij brenda territorit të Republikës së Kosovës, është i obliguar që të anëtarësohet në Odë.
2. Anëtarësimi i mjekut me shtetësi të huaj përfshin të gjitha dispozitat të cilat zbatohen te anëtarësimi i mjekut me shtetësi të Republikës së Kosovës, duke përfshirë edhe kushtet shtesë, si në vijim:

- 2.1 Leja e qëndrimit e afatshme në Republikën e Kosovës, e noterizuar, në pajtim me Ligjin për të huajt, në fuqi;
- 2.2 Vërtetimi nga Oda e Mjekëve e vendit të origjinës, me të cilin vërtetohet se është i anëtarësuar, e ka ushtruar profesionin e mjekut dhe se nuk i është shqiptuar ndonjë masë disiplinore.
- 2.3 Çertifikatë mbi të kaluarën kriminale në Polici;
- 2.4 Çertifikatë nga evidenca e të dënuarëve për vepër penale në Gjykatën përkatëse;
- 2.5 Diploma e Doktorit të Mjekësisë e nostrifikuar në MASHT (kopje e noterizuar), apo dëshmia se është në procedurë për nostrifikim;
- 2.6 Certifikata e Specializimit e nostrifikuar, duke u bazuar në ligjet në fuqi (kopje e noterizuar)
- 2.7 Licenca e punës valide nga vendi i origjinës (kopje e noterizuar);
- 2.8 Njohja e një nga gjuhët zyrtare në RKS, e vërtetuara nga organi kompetent; dhe
- 2.9 Nëse nuk njih një gjuhë zyrtare, duhet të vërtetohet se ka siguruar përkthyesin e Licencuar nga organi kompetent, i cili është i punësuar me orar të plotë në shërbim të mjekut të huaj, i cili aplikon për anëtarësim në Odë.

3. Anëtarësimi i mjekut me shtetësi të huaj bëhet sipas procedurës dhe mënyrës së njëjtë sikur për mjekun e RKS, me dallim që anëtarësimi i tyre menaxhohet në mënyrë të veçantë dhe mbikëqyret nga Komisioni për ALR.

## **Neni 10**

### **Procedura e Vendimmarrjes për anëtarësim dhe ri-anëtarësim**

1. Shërbimi profesional i OMK-së me rastin e pranimit të kërkesës për anëtarësim (Kopje e fortë ose aplikimi në sistem), parashtruesit i lëshon një Vërtetim ose email automatik kthyes, me të cilin dëshmohet dorëzimi i Kërkesës.
2. Vërtetimi përmbanë: datën e dorëzimit, numri i protokollit, dokumentet e dorëzuara dhe numri i faqeve të dokumentacionit, si dhe emri dhe mbiemri i zyrtarit që ka pranuar kërkesën dhe dokumentacionin përcjellës. Emaili automatik kthyes përmbanë vetëm njoftimin se aplikimi është kryer me sukses.
3. Pas pranimit të dokumentacionit sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, Shërbimi profesional i Odës, të njëjtin e procedon për shqyrtim në Komisionin për ALR.
4. Komisioni për ALR do të shqyrtojë dokumentacionin, në bazë të të cilit nxjerr vendim për parashtruesin, në afat 30 (tridhjetë) ditë nga dita e dorëzimit të kërkesës.
5. Me rastin e nxjerrjes së Vendimit për anëtarësim, Komisioni për ALR:

- 5.1 Aprovon anëtarësimin e parashtruesit të kërkesës;
- 5.2 Refuzon anëtarësimin e parashtruesit të kërkesës, për shkak të mosplotësimin të kushteve sipas kësaj Rregulloreje;
- 5.3 Refuzon anëtarësimin e parashtruesit të kërkesës, për shkak të ekzistimit të masës disiplinore aktive të shqiptuar nga organi kompetent i Odës.

6. Komisioni për ALR gjatë shqyrtimit mund të kërkojë nga parashtruesi i kërkesës plotësimin e dokumentacionit që kërkohet për anëtarësim si dhe fakteve të cilat konsiderohen relevante lidhur me lëndën, duke i dhënë afat për 14 (katërbëdhjetë) ditë, nga dita e njoftimit.

7. Lidhur me zbatimin e masës disiplinore të heqjes së mjekut nga Regjistri i anëtarësisë, Këshilli Etik e njofton me shkrim (Vendim) Komisionin për ALR.

8. Pala e pakënaqur me Vendimin e Komisionit për ALR, sipas paragrafit 5 të këtij neni, mund të parashtrojë Ankesë në Këshillin Drejtues të Odës, në afat 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, nga data e pranimit të Vendimit.

9. Dispozitat e këtij neni do të zbatohen përshtatshëmrisht edhe ndaj mjekut me shtetësi të huaj.

#### **Neni 11**

##### **Ç'anëtarësimi i vullnetshëm nga anëtarësia në Odë**

1. I anëtarësuar i cili dëshiron që vullnetarisht të ç'anëtarësohet nga Regjistri i anëtarëve në Odë, duhet të dorëzojë kërkesën në formë të shkruar, në të cilën paraqet arsyet e kërkesës për ç'anëtarësim.
2. Ç'anëtarësimi i vullnetshëm nga Regjistri i Mjekëve, bëhet me arsye të heqjes dorë nga ushtrimi i veprimtarisë mjekësore në RKS.
3. Komisioni për ALR pas shqyrtimit të dokumentacionit për ç'anëtarësim, nxjerr vendim për parashtruesin e kërkesës, në afat 30 (tridhjetë) ditë nga dita e dorëzimit të kërkesës.
4. Anëtari i OMK që ç'anëtarësohet vullnetarisht nga anëtarësia në OMK, do të publikohet në Listën e veçantë në ueb faqen zyrtare të OMK-së.

#### **Neni 12**

##### **Kartela e anëtarësisë së mjekut në Odë**

1. Me rastin e anëtarësimin, mjekut i lëshohet Kartela e anëtarësisë, në të cilën shënohet:



- 1.1 Emri dhe Mbiemri;
  - 1.2 Numri i Licencës së punës;
  - 1.3 Data e lëshimit të Kartelës së anëtarësisë;
  - 1.4 Numri rendor i anëtarësisë në Odë.
2. Përdorimi, humbja apo dëmtimi i Kartelës së anëtarësisë, do të trajtohen përshtatshëm sipas dispozitave të Rregullores së Komisionit për ALR.
  3. Kartela e anëtarësisë është pronë e OMK dhe me rastin e çanëtarësimin të mjekut, duhet t'u dorëzohet organit kompetent të OMK – Komisionit për ALR.

#### **Neni 13**

##### **Përditësimi i të dhënave të anëtarit të Odës**

Shërbimi Profesional i Odës, duhet të kryej përditësimin e të dhënave personale të mjekut në kohë reale, sipas kërkesës për përditësimin e informatave (ndryshimi i emrit, ndryshimi ose bashkëngjitja e mbiemrit, ndryshimi i vendbanimit, ndryshimi i vendit të punës, ndryshimi i statusit profesional, ndryshimi i të dhënave të komunikimit- nr. i telefonit mobil, email adresa, etj).

#### **Neni 14**

##### **Zbatimi i masave disiplinore të shqiptuara nga organet e mbikëqyrjes etike dhe profesionale të Odës**

1. Komisioni për ALR do të bëjë ekzekutimin e masës disiplinore sipas Vendimit të organit kompetent që ka shqiptuar masën disiplinore, në përputhje me procedurat e parapara me Rregulloren për Procedurat e Mbikëqyrjes Etike dhe Profesionale të OMK-së.
2. Komisioni për ALR është organ kompetent për ekzekutimin e masave disiplinore përkitazi me tërheqjen e përkohshme apo të përhershme të Licencës së punës dhe heqjen nga anëtarësia e mjekëve.
3. Komisioni për ALR me rastin e ekzekutimit të masës disiplinore, do të njoftoj Këshillin Etik të Odës, në mënyrë që kjo masë të evidentohet në Regjistrin e veçantë për masat e shqiptuara.

#### **Neni 15**

##### **Mospërmbushja e obligimeve të Mjekut**

1. Në rastet kur aplikuesi-mjeku nuk ka përfillur afatin e anëtarësimit në OMK (vonesë në anëtarësim), atëherë Komisioni për ALR e paraqet rastin përkatës te Prokurori i Odës.

## **Kapitulli IV – Licencimi i mjekut**

### **Neni 16**

#### **Detyrimi për Licencim/Rilicencim**

1. Licencimi dhe Rilicencimi i mjekut është i detyrueshëm, për ushtrimin e veprimtarisë mjekësore dhe veprimtarisë në sistemin shëndetësor, sipas autorizimeve ligjore.
2. Licencimi dhe Rilicencimi është procedurë e veçantë administrative që ka karakter zyrtar dhe publik.
3. Licenca e punës është dokument publik i cili vërteton përmbushjen e kushteve nga ana e mjekut, e që janë përcaktuar në mënyrë taksative me dispozitat e kësaj Rregulloreje.
4. Komisioni për ALR udhëhiqet mbi bazën e parimeve në mbrojtje të interesit të përgjithshëm publik.

### **Neni 17**

#### **Inicimi i procedurës për Licencim/Rilicencim**

1. Procedura për Licencim dhe Rilicencim të Doktorit të mjekësisë, Specialistit apo Sub-specialistit të lëmisë përkatëse mjekësore, inicohet nga mjeku ose personi i autorizuar, me parashtrimin e kërkesës në kopje të fortë apo përmes sistemit.
2. Kërkesa për Licencim apo Rilicencim duhet të plotësohet dhe të nënshkruhet nga mjeku apo personi i autorizuar prej tij.
3. Mjeku apo personi i autorizuar, duhet ta inicioj procedurën për Licencim apo Rilicencim 30 (tridhjetë) ditë para skadimit të afatit të Licencës aktuale të punës.
4. Komisioni për ALR do të procedojë te Prokurori i Odës, mjekun i cili nuk respekton afatin nga paragrafi 3 i këtij neni.

5. Shërbimi Profesional i Odës me rastin e pranimit të kërkesës, parashtruesit i lëshon një Vërtetim apo e-mail automatik kthyes me të cilin dëshmohet pranimi i Kërkesës për Licencim apo Rilicencim.
6. Vërtetimi përmbanë: datën e pranimit, numrin e protokollit, dokumentet e dorëzuara dhe numri i faqeve të dokumentacionit, si dhe emri dhe mbiemri i zyrtarit që ka pranuar kërkesën dhe dokumentacionin përcjellës. Ndërkaq, e-maili automatik kthyes përmbanë vetëm njoftimin se aplikimi është kryer me sukses.
7. Kërkesa për Licencim apo Rilicencim të Doktorit të mjekësisë, Specialistit dhe Sub-specialistit të lëmive përkatëse profesionale, procedohet te Komisioni për Edukim të Vazhdueshëm Profesional. Ky Komision nxjerrë Vërtetim për vlerësimin e pikëve kredituese, dhe bashkë me Dokumentacionin e nevojshëm, të njëjtin e procedon te Komisioni për ALR.
8. Shërbimi Profesional i Odës, pas pranimit të dokumentacionit të kompletuar sipas këtij neni, të njëjtin e procedon te Komisioni për ALR për shqyrtim.
9. Mënyra e vlerësimit kreditues lidhur me edukimin e vazhdueshëm profesional është përgjegjësi e Komisionit për EVP dhe çështjet përkritazi me këtë procedurë rregullohen me akt të veçantë normativ.

### Neni 18

#### Kushtet për Licencimin dhe Rilicencimin e Doktorit të mjekësisë

1. Doktor i Mjekësisë për t'u Licencuar, duhet të plotësojë këto kushte:
  - 1.1 Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
  - 1.2 Të jetë i diplomuar në lëminë mjekësore në ndonjërin nga institucionet e akredituara të arsimit të lartë apo të ketë të nostrifikuar programin universitar sipas legjislacionit në fuqi;
  - 1.3 Të ketë dhënë Provimin profesional;
  - 1.4 Të jetë i anëtarësuar në OMK;
  - 1.5 Të paguaj anëtarësinë në OMK; dhe
  - 1.6 Të paguaj taksën administrative për dorëzim të kërkesës.
2. Doktor i Mjekësisë për t'u Rilicencuar duhet të plotësojë këto kushte:
  - 2.1 Të plotësojë kushtet nga paragrafi 1 i këtij neni;
  - 2.2 Të ketë 100 pikë akredituese brenda periudhës 5 vjeçare (në atë mënyrë që pikët kredituese duhet të shpërndahen në minimum 10 (dhjetë) pikë për vit kalendarik;
  - 2.3 KEVP bën vlerësimin e pikëve akredituese dhe lëshon Vërtetim për këtë proces.

3. Nëse aplikuesi për Licencim për herë të parë ka dhënë Provimin shtetëror më tepër se pesë (5) vite nga data e parashtrimit të kërkesës për Licencim, aplikuesi obligohet t'i nënshtrohet sërish Provimit shtetëror.

## Neni 19

### Rilicencimi i mjekut i cili nuk përmbush kriteret e EVP për Rilicencim

1. Mjeku i cili nuk ka plotësuar kriteret e EVP-së, respektivisht nuk ka grumbulluar 100 (njëqind) pikë kredituese përmes aktiviteteve, obligohet t'i nënshtrohet Provimit për Rilicencim.
2. Provimi për Rilicencim organizohet nga Komisioni për provim të Rilicencimit, i përbërë nga kryetari i Komisionit për ALR dhe dy anëtarë të tjerë, të zgjedhur nga Komisioni për ALR.
3. Dy anëtarët e zgjedhur duhet të jenë profesionistë me thirrje Akademike/Shkencore të fushës gjegjëse apo Specialistë të fushës, me përvojë pune mbi 10 (dhjetë) vjetë. Në rast se nuk ka të tillë, atëherë nga Specialistë të fushës me 5 (pesë) vjet përvojë pune.
  - Aplikuesi do t'i nënshtrohet provimit sipas gjendjes së pikëve kredituese në vijim:
  - Mjeku i cili ka grumbulluar 0 deri në 50 (pesëdhjetë) pikë kredituese, do t'i nënshtrohet stazhit praktik me mentorim (te Mentori i zgjedhur) në kohëzgjatje deri 3 muaj (varësisht nga pikët e grumbulluara), dhe Provimit teorik të Komisionit përkatës; dhe
  - Mjeku i cili ka grumbulluar 50 - 94 pikë, do t'i nënshtrohet Provimit teorik (tek Komisioni përkatës).
4. Mjeku i cili posedon Licencë pune të skaduar dhe dëshiron të rifitojë të njëjtën, i nënshtrohet stazhit praktik dhe Provimit teorik të lëmisë gjegjëse në Komisionin përkatës, vetëm për rastet si në vijim:
  - 4.1 Mjeku me Licencë punë të skaduar deri 5 vite, obligohet të kryej stazhin praktik nga lëmia gjegjëse në kohëzgjatje prej 1 viti;
  - 4.2 Mjeku me Licencë punë të skaduar prej 5 deri 10 vite, obligohet të kryej stazhin praktik nga lëmia gjegjëse në kohëzgjatje prej 2 viteve;
  - 4.3 Mjeku me Licencë punë të skaduar mbi 10 vite, Komisioni për ALR në koordinim me Bordin dhe Komitetin Specialistik të MSh cakton stazhin praktik në fushën gjegjëse.
5. Komisioni për ALR cakton Mentorin për stazhin praktik dhe anëtarët e Komisionit për Provimin teorik.
6. Mjeku i cili nuk posedon Licencë pune për më shumë se 20 vite nuk mund të licencohet në Odë.

7. Aplikuesi pas përfundimit të stazhit praktik i nënshtrohet Provimit teorik në Komisionin e caktuar nga Komisioni për ALR.

## **Neni 20**

### **Mënyra e aplikimit dhe taksat për Provimin e Rilicencim**

1. Aplikuesi për Provim të Rilicencimit duhet të dorëzojë kërkesën sipas shtojcës III, së bashku me arsyetimin e mosgrumbullimit të pikëve kredituese dhe taksën administrative.
2. Komisioni për Licencim do të shqyrtojë kërkesën së bashku me dokumentacionin përcjellës për provim të Rilicencimit dhe do të nxjerrë Vendim për lëndën përkatëse në afat 30 (tridhjetë) ditë nga dita e dorëzimit të kërkesës.
3. Aplikuesi do të njoftohet pesëmbëdhjetë (15) ditë para mbajtjes së provimit të Rilicencimit.
4. Pas përfundimit të provimit teorik dhe praktik, Komisioni për Licencim, me rekomandim të Komisionit për provim të Rilicencimit, do të nxjerrë Vendimin (së bashku me Licencën) për Rilicencim e aplikuesit.
5. Taksa administrative për provimin e Rilicencimit është e përcaktuar sipas akteve juridike të nxjerra nga Kuvendi i Odës për përcaktimin e taksave administrative në Odë.

## **Neni 21**

### **Përmbajta e Kërkesës dhe Dokumentet për dorëzim lidhur me Licencimin dhe Rilicencimin e Doktorit të mjekësisë**

1. Doktorit të mjekësisë i cili aplikon për Licencim dhe Rilicencim, duhet të dorëzojë:
  - 1.1 Kërkesën për Licencim dhe Rilicencim;
  - 1.2 Dokumentet tjera përcjellëse.
2. Kërkesa për Licencim dhe Rilicencimin e Doktorit të mjekësisë përmban të dhënat si në vijim:
  - 2.1 Emri i personit, Emri i prindit dhe mbiemri;
  - 2.2 Data e lindjes dhe vendi;
  - 2.3 Adresa e vendbanimit;
  - 2.4 Vendi dhe data e diplomimit;
  - 2.5 Të dhënat për institucionin punëdhënës paraprak, vendin aktual të punës, pozitën, respektivisht institucionin punëdhënës në të cilin është në marrëdhënie të punës;
  - 2.6 Numri i telefonit;
  - 2.7 Adresa elektronike (e-mail);
  - 2.8 Emri dhe mbiemri, nënshkrimi, data e aplikimit.

3. Dokumentet tjera që duhet dorëzuar krahas kërkesës me rastin e Licencimit të Doktorit të mjekësisë janë:
  - 3.1 Kopja e noterizuar e Diplomës univeristare,
  - 3.2 Në rast se aplikuesi ka përfunduar studimet jashtë vendit, duhet dorëzuar Vendimin në kopje të noterizuar të organit kompetent për nostrifikimin e Diplomës së vendit të huaj, të lëshuar nga MASHT;
  - 3.3 Certifikata e Provimit profesional në kopje të noterizuar;
  - 3.4 Deklarata e nënshkruar nën betim;
  - 3.5 Leternjoftimi i afatshëm – kopje, dhe
  - 3.6 Fletëpagesa për taksën administrative për Licencim.

## **Neni 22**

### **Kërkesa dhe Dokumentet tjera për dorëzim, lidhur me Licencimin dhe Rilicencimin e Specialistit dhe Sub-specialistit të mjekësisë**

1. Kërkesa për Licencim dhe Rilicencimin e Specialistit dhe Sub-specialistit të mjekësisë përmban këto të dhëna:
  - 1.1 Emri i personit, Emri i prindit dhe mbiemri;
  - 1.2 Data e lindjes dhe vendi;
  - 1.3 Adresa e vendbanimit;
  - 1.4 Vendi dhe data e diplomimit universitar;
  - 1.5 Vendi dhe data e diplomimit pasuniversitar;
  - 1.6 Të dhënat për institucionin shëndetësor të përshtatet si me lartë ose institucionin tjetër në të cilin ka punuar, vendin aktual të punës, pozitën, respektivisht institucionin shëndetësor nëse është në marrëdhënie të punës;
  - 1.7 Lloji i specializimit;
  - 1.8 Data e specializimit
  - 1.9 Numri i telefonit;
  - 1.10 Adresa e e-mail;
  - 1.11 Emri dhe mbiemri, nënshkrimi, data e aplikimit.
2. Dokumentet që duhet dorëzuar me rastin e Licencimit të Specialistit dhe Sub-specialistit të mjekësisë janë:
  - 2.1 Diploma e Doktorit të Mjekësisë (kopje e noterizuar);
  - 2.2 Në rast se aplikuesi ka përfunduar studimet jashtë vendit, duhet dorëzuar Vendimin në kopje të noterizuar të organit kompetent për nostrifikimin e diplomës së vendit të huaj, të lëshuar nga MASHT (numri i aplikimit);
  - 2.3 Certifikata e Provimit Specialistik apo Sub-specialistik në kopje të noterizuar;

- 2.4 Në rast se aplikuesi ka përfunduar specializimin apo sub-specializimin jashtë vendit, duhet dorëzuar Vendimin në kopje të noterizuar të organit kompetent për nostrifikimin e Certifikatës së specializimit apo sub-specializimit të vendit të huaj, të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë;
  - 2.5 Deklarata nën betim e nënshkruar; dhe
  - 2.6 Fletëpagesa për taksën administrative për inicim të procedurës së Licencimit.
3. Për Rilicencimin e Specialistit dhe Sub-specialistit të lëmive përkatëse të mjekësisë, krahas kushteve të parapara me paragrafin 1 të këtij neni, parashtruesi i kërkesës duhet të përmbushë së paku 100 (njëqind) pikë kredituese për edukimin e vazhdueshëm profesional gjatë ushtrimit të profesionit, duke respektuar afatin e vlefshmërisë së Licencës së punës.
  4. Vlerësimi i pikëve kredituese bëhet nga Komisioni për EVP, me ç'rast aplikuesit i lëshohet Vendim, me të cilin vërtetohet numri i pikëve kredituese sipas aktiviteteve që janë kryer brenda periudhës përkatëse.
  5. Aplikuesi për Rilicencim i cili posedon dy apo më shumë Licenca të punës me specializime të veçanta, duhet të fitojë së paku 100 (njëqind) pikë kredituese për secilin specializim/sub-specializim.

### **Neni 23** **Rilicencimi i mjekut në pension**

1. Mjeku në pension i moshës 65 deri 70 vjeçare obligohet që Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga institucioni i autorizuar, ta dorëzojë te Komisioni për Licencim, çdo dy vite kalendarike.
2. Mjeku në pension mbi moshën 70 vjeçare obligohet që Certifikatën shëndetësore ta dorëzojë te Komisioni për ALR, çdo vit kalendarik.

### **Neni 24** **Vendimmarrja dhe lëshimi i Licencës së punës**

1. Komisioni për ALR shqyrton kërkesën së bashku me dokumentacionin përcjellës për Licencim apo Rilicencim dhe nxjerrë Vendim për lëndën përkatëse, në afat prej 30 (tridhjetë) ditë nga dita e dorëzimit të kërkesës.
2. Me rastin e nxjerrjes së Vendimit për Licencim apo Rilicencim të aplikuesit, Komisioni mund të:
  - 2.1 Apropojë kërkesën për Licencim apo Rilicencim të aplikuesit;
  - 2.2 Të refuzojë kërkesën për Licencim apo Rilicencim të aplikuesit, për shkak të mosplotësimit të kushteve sipas kësaj Rregulloreje; apo

2.3 Të refuzojë Licencimin apo Rilicencim për shkak të ekzekutimit apo ekzistimit të masës disiplinore të heqjes nga Regjistri ndaj aplikuesit.

3. Komisioni për Licencim gjatë shqyrtimit të lëndës mund të kërkojë nga parashtruesi të bëjë plotësimin e dokumentacionit që kërkohet në afat prej 14 (katërbëdhjetë) ditë nga dita e njoftimit.
4. Pala e pakënaqur ndaj Vendimit të Komisionit për ALR sipas paragrafit 2 të këtij neni, mund të parashtrojë Ankesë pranë Këshillit Drejtues të OMK-së në afat 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e pranimin të Vendimit.
5. Aplikuesi i cili me rastin e dorëzimit të dokumentacionit për Rilicencim nuk ka dorëzuar Licencën e punës origjinale, këtë duhet ta bëjë me rastin e pranimin të Licencës së punës të re. Në të kundërtën i njëjti nuk mund të tërheq Licencën e punës të re.
6. Me rastin e dorëzimit të Licencës së punës, kjo procedurë do të evidentohet në Regjistrin e pranim-dorëzimit të Licencave.
7. Në bazë të Vendimit të Komisionit për ALR, Kryetari i Komisionit për ALR dhe Kryetari i Odës e nënshkruajnë Licencën e punës, e cila i dorëzohet personalisht parashtruesit.
8. Aplikuesi i cili me rastin e dorëzimit të dokumentacionit për Rilicencim nuk ka dorëzuar Licencën e punës origjinale, këtë duhet ta bëjë me rastin e pranimin të Licencës e re të punës. Në të kundërtën i njëjti nuk mund të tërheq Licencën e re të punës.
9. Licenca e punës origjinale e skaduar që dorëzohet nga parashtruesi i kërkesës, do të arkivohet në dosjen e tij, nga Shërbimi Profesional i Odës.

## **Neni 25**

### **Afatshmëria e Licencës së punës**

1. Licenca e punës për Doktorin e mjekësisë, Specialistët dhe Sub-specialistin e lëmive përkatëse të mjekësisë lëshohet me afat prej 5 (pesë) viteve e nënshkruar nga Kryetari i Komisionit për ALR dhe nga ana e Kryetarit të OMK-së.
2. Përrjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, Licenca e punës mund të lëshohet në afat më të shkurtër me kërkesë të parashtruesit të kërkesës, nëse arsyeja ka të bëjë me arrijtjen e titullit specialistik.
3. Licenca e punës e lëshuar sipas paragrafit 2 të këtij neni do të lëshohet në përputhje me vitin e fundit të programit specialistik të cilit i nënshtrohet parashtruesi i kërkesës.



4. Në rast të humbjes së statusit të anëtarit të OMK-së, mjekut i pushon validiteti i Licencës së punës.
5. Organi përkatës i Odës duhet të informojë organet përkatëse në Ministrinë e Shëndetësisë, Inspektoratin Shëndetsor dhe Punëdhënësin për skadimin e vlefshmërisë së Licencës së punës të Doktorit të mjekësisë, Specialistit dhe Sub-specialistit.

#### **Neni 26**

#### **Licenca dhe përgjegjësia e përdorimit**

1. Licenca e punës i lëshohet mjekut ose të autorizuarit të tij, në vetëm 1 (një) ekzemplar original.
2. Licenca e punës nuk mund të përdoret nga ndonjë person tjetër, në mënyrë që të arsyetoj ushtrimin e veprimtarisë mjekësore.
3. E drejta për të ushtruar veprimtari mjekësore në bazë të Licencës së punës të lëshuar, nuk mund të bartet te personi tjetër.
4. I Licencuari është përgjegjës për ruajtjen dhe përdorimin e Licencës së punës sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.
5. Në rast të humbjes së Licencës së punës, i Licencuari këtë humbje duhet ta publikoj në njërin nga gazetatat ditore vendore. Fotokopjen e këtij publikimi duhet t'ja bashkangjesë Shkresës njoftuese të dorëzuar në Shërbimin Profesional të Odës.
6. Në rast të dëmtimit të Licencës së punës, i Licencuari do të njoftojë përmes shkresës zyrtare Shërbimin Profesional të Odës, duke i bashkangjitur licencën origjinale të dëmtuar.
7. Në rast se Licenca është dëmtuar aq shumë sa që nuk ka mbetur asnjë pjesë, i Licencuari konsiderohet se ka përmbushur detyrimin e tij me dorëzimin e shkresës zyrtare në të cilën sqaron këto rrethana.
8. Parashtruesi i kërkesës për lëshim të ekzemplarit të dublikuar të Licencës, është i obliguar që të paguajë taksën administrative për këtë shërbim në përputhje me aktet juridike të nxjerra nga Kuvendi i Odës për përcaktimin e taksave administrative në Odë.
9. Me rastin e marrjes së Licencës së punës, mjeku është i obliguar që të nënshkruaj Deklaratën e betimit të mjekut.

#### **Neni 27**

#### **Dokumenti i Licencës së punës dhe Faksimili**

1. Organet profesionale të Odës i dorëzojnë parashtruesit të kërkesës, Dokumentin e Licencës së punës dhe Faksimilin.
2. Dokumenti i Licencës së punës përmban të dhënat si në vijim:
  - 2.1 Pjesën hyrëse, në të cilën shënohet baza juridike e lëshimit të Licencës së punës;
  - 2.2 Emri dhe mbiemri i të Licencuarit;
  - 2.3 Thirrja profesionale, përfshirë këtu Specializimin apo Subspecializimin;
  - 2.4 Data dhe vendi i lindjes;
  - 2.5 Numri i Diplomës dhe Certifikatës së Specializimit;
  - 2.6 Kodi i Licencës së punës;
  - 2.7 Data e lëshimit dhe data e skadimit të Licencës së punës;
  - 2.8 Numri personal; dhe
  - 2.9 Nënshkrimi i Kryetarit të OMK-së dhe Kryetarit të Komisionit për ALR.
3. Me rastin e lëshimit të Licencës së punës, të Licencuarit i dorëzohet Faksimili i cili shërben si shenjë e identifikimit personal dhe profesional.
4. Faksimili ka këtë përmbajtje:
  - 4.1 Llogo e OMK-së “OMK”;
  - 4.2 Emrin dhe mbiemrin e të Licencuarit;
  - 4.3 Thirrjen profesionale për të cilën është Licencuar;
  - 4.4 Kodin e Licencës së punës;
  - 4.5 Numrin e antarësisë.
5. Të Licencuarit i cili posedon dy apo më shumë Licenca të punës me specializime të ndryshme, do të lëshohet Faksimil i veçantë për secilën Licencë Specialistike/Sub-specialistike.
6. Madhësia dhe lloji i shkronjave në Faksimil përcaktohen me Vendim të Këshillit Drejtues të OMK-së.
7. Pronar juridik i faksimilit është OMK, dhe si i tillë duhet t'i dorëzohet organit kompetent në këto dy raste:
  - me rastin e dorëzimit të Licencës së punës të skaduar, për të cilën është lëshuar faksimili i tillë; dhe
  - me rastin e ç'anëtarësimit të mjekut nga Regjistri i anëtarësisë.
8. Faksimili i cili vlerësohet si i pavlerë për shkak të ndryshime përmbajtësore në të dhëna, për shkak të dëmtimit ose përmbajtjes së gabimeve teknike, do të asgjësohet nga Komisioni i veçantë i emëruar nga Komisioni për ALR.
9. Të dhënat personale dhe të dhënat tjera relevante që evidentohen në Regjistrin e anëtarësisë së Odës, në Regjistrin e Licencimit dhe Rilicencimit, dokumentin e Licencës së punës dhe në

Faksimil, do të bazohen në Dokumentin e lëshuar nga organi përkatës shëndetësor arsimor dhe nga organi i gjendjes civile, i cili nuk do të jetë më i vjetër se 6 (gjashtë) muaj, apo letërnjoftimit me afat valid.

10. Në rast të dëmtimit apo humbjes së Faksimilit nga anëtari i OMK, i njejtë është i obliguar që në afat sa më të shkurtër kohor ta njoftojë Odën dhe sipas mundësisë ta dorëzojë kërkesën për Faksimilin e dytë, bashkë me publikimin e humbjes së Faksimilit në ndonjërin nga mediat e shkruara.
11. Zyrtari përgjegjës i Shërbimit Profesional të Odës është i obliguar që faksimilin e ri (faksimil të dëmtuar apo të humbur), ta dërgojë te operatori ekonomik për përgatitje, në momentin e pranimit të kërkesës së parashtruar nga mjeku.

#### **Neni 28**

##### **Licenca për dy e më shumë specializime/subspecializime**

1. I Licencuari i cili është i specializuar në më shumë se një lëmi specialistike/Sub-specialistike, për secilin specializim/subspecializim i lëshohet Licencë pune e veçantë.
2. Licenca e punës për secilin specializim/subspecializim të veçantë ka numër unik identifikues dhe si të tilla janë dokumente të veçanta, për të cilat poseduesi i tyre ka përgjegjësi të ruajtjes dhe mirëpërdorimit.

#### **Neni 29**

##### **Kopja e dublikuar e Licencës së punës**

1. Me kërkesë të mjekut, Komisioni i ALR mund të lëshojë Licencë pune të dublikuar, në të cilën do të të shënohet se ky ekzemplar është dublikat i Licencës së punës origjinale.
2. Komisioni do të lëshojë Licencën e punës të dublikuar në afat të përputhshëm me afatin e Licencës së punës origjinale.
3. Parashtruesi i kërkesës për lëshimin e Licencës së punës të dublikuar, është i obliguar që të paguajë taksën administrative për këtë shërbim, në përputhje me aktin juridik të nxjerrë nga Kuvendi i Odës për përcaktimin e taksave administrative në Odë.

**Neni 30**  
**Taksat administrative**

1. Taksa administrative për anëtarësim dhe anëtarësim, Licencim dhe Rilicencim caktohet duke u bazuar në Vendimet e Kuvendit të OMK-së.
2. Taksa administrative për Licencim caktohet për periudhën 5 (pesë) vjeçare, aq sa është vlefshmërisë së Licencës.
3. Taksa administrative caktohet edhe për iniciimin e procedurës së Licencimit dhe Rilicencimit.
4. I Licencuari krahas pagesës së taksës administrative për Licencë pune, është i obliguar që të paguaj taksën administrative për lëshim të Faksimilit.

**Neni 31**

**Gjobat ndëshkuese mospërbushje të obligimeve për Rilicencimin**

1. Në rastet kur aplikuesi nuk ka përfillur afatin e Rilicencimit (vonesë në Rilicencim) në kohëzgjatje deri në tre (3) muaj Komisioni i ALR do të shqiptojë gjobë administrative në shumën 100% të taksës administrative të Licencës së punës për secilin muaj vonesë.
2. Në rastet kur aplikuesi nuk ka përfillur afatin e Rilicencimit (vonesë në Rilicencim) në kohëzgjatje prej më shumë se tre (3) muaj, Komisioni i ALR paraqet rastin përkatës te Prokurori i Odës, i cili konform akteve juridike të Odës dhe legjislacionit në fuqi në RKS inicon procedurën disiplinore ndaj mjekëve të cilët nuk kanë përmbushur detyrimin e tyre për t'u rilicencuar, ashtu siç obligon ligji.
3. Ndaj vendimit me të cilin Komisioni shqipton gjobën administrative, palët e pakënaqura mund të parashtrajnë ankesë në afat prej 15 (pesëmbdhjetë) ditëve nga dita e pranimi të vendimit nga ana e palës. Ankesa e tillë parashtrohet tek Këshilli Drejtues përmes Komisionit për ALR.

**Kapitulli V - Dispozitat përfundimtare**

**Neni 32**


**Hyrja në fuqi**

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja paraprake e Punës së Komisionit për ALR.
2. Ndeshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje bëhen sipas të njejtës procedurë së miratimit.

3. Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit të saj nga Kuvendi i OMK-së

**Prishtinë, 4 nëntor 2024**

Kryetari i OMK-së  
Dr. Pleurat Sejdiu, Mr.sci



---



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

SHTOJCA I

KËRKESË PËR ANËTARËSIM

I. Të dhëna personale TË DHËNAT DUHET TË SHËNOHEN ME SHKRONJA TË MËDHA TË SHTYPIT)

Emri, Emri i prindit dhe mbiemri			
Data e lindjes	Dita:	Muaji:	Viti:
Vendlindja			
Numri personal		Shtetësia:	
EM i pagës (për sektorin publik)			
Emri dhe adresa e institucionit shëndetësor/Ordinancës/Klinika aktual			
Statusi profesional/specialistik			
Grada Shkencore			
Kodi i Licencës			

II. Adresa aktuale

Adresa	
Qyteti	
Kodi postar	

III. Të dhënat e komunikimit

Numri i telefonit të zyrës	
Numri i telefonit mobil	
Email adresa	

Vendi	Data	Nënshkrimi

Të dhënat personale të deklaruara në këtë Kërkesë përpunohen në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Në faqen tjetër gjeni të shënuara Dokumentet që duhet të bashkangjiten me rastin e parashtrimit të kërkesës për antarësim.

**Deklaratë**

Kërkesa e anëtarësimit plotësohet për të përmbushur detyrimin ligjor për anëtarësim në Odën e Mjekëve të Kosovës, në pajtim me dispozitat e Nenit 8 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor. Deklaroj se të dhënat e shënuara më lartë janë të sakta dhe për deklarimin e tillë mbaj përgjegjësi personale.

**IV. Dokumentet e nevojshme**

1. Dy (2) fotografi me dimensione 3cm × 4cm;
2. Kopjen e letërnjoftimit;
3. Kopjen e noterizuar të Licencës së punës;
4. Kërkesa për anëtarësimin dhe specifikimin e të dhënave personale (të mbushet komplet);
5. Kopja e noterizuar e diplomës së studimeve dhe dëshmi të tjera të cilat vërtetojnë specializimin/aftësimin profesional dhe kualifikimin e cituar në Kërkesan për antarësim;
6. Dëshminë e pagesës pesë (5) euro për anëtarësim në regjistrin e antarësisë.



OD A E M J E K Ë V E T Ë K O S O V Ë S  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

SHTOJCA II

KOMISIONI PËR LICENCIM

KËRKE S Ë PËR LICENCIM / RILICENCIM  
TË PËRGJITHSHËM / SPECIALISTIK

Numri i Licencës:  
(në rast të aplikimit për Rilicencim  
apo Licencim specialistik)

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Kërkesa është dorëzuar për:

- Licencim i përgjithshëm     Licencim specialistik  
 Rilicencim i përgjithshëm     Rilicencim specialistik

TË DHËNAT E MËPOSHTME SHËNOHEN PERSONALISHT NGA PARASHTRUESI I  
KËRKE S Ë S  
(Të dhënat të shënohen me shkronja të shtypit)

Emri, emri i prindit dhe mbiemri		
Data dhe vendi i lindjes		
Numri personal		
Adresa		
Numri i telefonit		
Vendi dhe data e diplomimit		
Detaje mbi vendin e punës	Emri i institucionit shëndetësor aktual	
	Data e punësimit Dhe Vendi	
	Specializimi	
	Data specializimit	

Deklaroj se të dhënat e lartshënuara janë të vërteta dhe për daklarimin e tyre mbajë përgjegjësi penale dhe civile.

Anëtar i Odës	Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi	Data
PO / JO (të rrumbullakësohet)			

Të dhënat personale të deklaruar në këtë Kërkesë përpunohen në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale



**Plotësohet nga personi i autorizuar pranë OMK-së**

<b>Dokumentacioni për aplikim:</b>			
<b>Licencim të përgjithshëm</b>	<b>RiLicencim i përgjithshëm</b>	<b>Licencimi specialistik/Sub-specialistik</b>	<b>RiLicencimi specialistik/Sub-specialistik</b>
Kërkesa	Kërkesa	Kërkesa	Kërkesa
Diploma universitare (kopje e noterizuar)	Certifikata e valorizimit të pikëve kredituese nga KEVP-ja	Certifikata e provimit specialistik/Sub-specialistik (kopje e noterizuar)	Certifikata e valorizimit të pikëve kredituese nga KEVP-ja
Certifikata e provimit të Licencës (kopje e noterizuar)	Licenca e skaduar	Licenca e skaduar	Licenca specialistike/Sub-specialistike e skaduar
Kopja e letërnjoftimit	Thirrjet shkencore si Mr.Sci; Dr.Sci;Ass; Mr.Sci; Dr.Sci; (kopje e noterizuar)	Thirrjet shkencore si Mr.Sci; Dr.Sci;Ass; Mr.Sci; Dr.Sci; (kopje e noterizuar)	Thirrjet shkencore si Mr.Sci; Dr.Sci;Ass; Mr.Sci; Dr.Sci; (kopje e noterizuar)
Fletëpagesa	Kopja e letërnjoftimit	Kopja e letërnjoftimit	Kopja e letërnjoftimit
	Fletëpagesa	Fletëpagesa	Fletëpagesa

*Afati i shqyrtimit të kërkesës: 30 (tridhjetë) ditë nga data e dorëzimit*

Në rast se parashtruesi i kërkesës nuk është anëtar i OMK-së, personi zyrtar vërteton parashtrimin e Kërkesës për anëtarësim në OMK dhe përmbushjen e obligimeve statutore për anëtarësim.

Parashtruar Formulari për anëtarësim

Anëtar

Personi i autorizuar i OMK-së

<b>Emri dhe Mbiemri</b>	<b>Nënshkrimi</b>	<b>Data</b>

V.V.

## KËRKESE PËR ÇANËTARËSIM

### I. Të dhëna personale (TË DHËNAT DUHET TË SHËNOHEN ME SHKRONJA TË MËDHA TË SHTYPIT)

Emri, Emri i prindit dhe mbiemri			
Data e lindjes	Dita:	Muaji:	Viti:
Vendlindja			
Numri personal			
Shtetësia			
Statusi profesional/specialistik		Nr. Licencës	
Numri i kartelës së anëtarësisë në OMK			

### II. Adresa aktuale

Adresa	
Qyteti	

### III. Të dhënat e komunikimit

Numri i telefonit	
Email adresa	

### Arsyet e parashtrimit të kërkesës për çanëtarësim

--

### Deklaratë

Unë, i lartëshënuari me të dhënat personale, e plotësoj këtë Kërkesë për çanëtarësim për arsyet e lartcekura. Deklaroj nën përgjegjësinë time civile dhe penale se të dhënat e shënuara më lartë janë autentike dhe për deklarimin e tillë kam përgjegjësi ekskluzivisht personale, përfshirë këtu edhe përgjegjësinë për arsyen e deklaruar për çanëtarësim të deklaruar në këtë Formularë.

Vendi	Data	Nënshkrimi



**ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS**  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA  
**KOMISIONI PËR LICENCIM**

**KËRKESË PËR PROVIM TË RILICENCIMIT  
TË PËRGJITHSHËM / SPECIALISTIK**

Numri i Licencës:

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Kërkesë është dorëzuar për:

Rilicencim i përgjithshëm     Rilicencim specialistik

**TË DHËNAT E MËPOSHTME SHËNOHEN PERSONALISHT NGA PARASHTRUESI I  
KËRKESËS**  
(Të dhënat të shënohen me shkronja të shtypit)

Emri, emri i prindit dhe mbiemri		
Data dhe vendi i lindjes		
Numri personal		
Adresa		
Numri i telefonit		
Vendi dhe data e diplomimit		
Detaje mbi vendin e punës	Emri i institucionit shëndetësor	
	Data e punësimit Dhe Vendi	
	Specializimi	
	Data specializimit	

Deklaroj se të dhënat e lartshënuara janë të vërteta dhe për daklarimin e tyre mbajë përgjegjësi penale dhe civile.

Anëtar i Odës	Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi	Data
PO / JO (të rrumbullakësohet)			

Të dhënat personale të deklaruar në këtë Kërkesë përpunohen në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

**Plotësohet nga personi i autorizuar në OMK**

Dokumentacioni për aplikim:	
RiLicencim i përgjithshëm	RiLicencimi specialistik/Sub-specialistik
Kërkesa	Kërkesa
Certifikata e valorizimit të pikëve kredituese nga KEVP-ja	Certifikata e valorizimit të pikëve kredituese nga KEVP-ja
Licenca e skaduar	Licenca specialistike/Sub-specialistike e skaduar
Arsyetimi i mosgrumbullimit të pikëve kredituese	Arsyetimi i mosgrumbullimit të pikëve kredituese
Kopja e letërnjoftimit	Kopja e letërnjoftimit
Fletëpagesa	Fletëpagesa

*Afati i shqyrtimit të kërkesës: 30 (tridhjetë) ditë nga data e dorëzimit*

Në rast se parashtruesi i kërkesës nuk është anëtar i OMK-së, personi zyrtar vërteton parashtrimin e Kërkesës për anëtarësim në OMK dhe përmbushjen e obligimeve statutore për anëtarësim.

Parashtruar Formulari për anëtarësim

Anëtar

Personi i autorizuar i OMK-së

Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi	Data

V.V.